



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____.____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje ushqime për kopështin Divjakë dhe kopështin Çermë
Sektor, Njësia Administrative Tërbuf, Bashkia Divjakë”**

Loti I. “Blerje buke”

Loti II. “Blerje artikuj bulmetorë”

Loti III. “Blerje artikuj ushqimorë dhe fruta perime”

Loti IV. “Blerje mishi dhe nënprodukte të tij”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 03200000-3
Drithëra, patate, perime, fruta dhe arra, (CPV):15111200-1 Mish viçi, (CPV):15800000-6
Produkte ushqimore të ndryshme, (CPV):15811100-7 Bukë, (CPV): 15511000-3 Qumësht,
(CPV): 15542000-9 Djathë i freskët, (CPV):15542100-0 Gjizë, (CPV):15551300-8 Kos.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5,248,531.17 (pesë milion e dyqind e dyzetë e tetë mijë e pesëqind
e tridhjetë e një e shtatëmbëdhjetë të qintat) lekë pa Tvsh, nga e cila: 3,223,149.51 (tre milion e
dyqind e njëzetë e tre mijë e njëqind e dyzetë e nëntë e pesëdhjetë e një të qindat) lekë pa Tvsh
nga Granti dhe 2,025,381.66 (dy milion e njëzetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e një e
gjashtëdhjetë e gjashtë të qindat) lekë pa Tvsh nga Të ardhurat, i ndarë në lote si mëposhtë:**

**Loti I. “Blerje buke” me fond limit: 273,369.60 (dyqind e shtatëmbëdhjetë e tre mijë e treqind e
gjashtëdhjetë e nëntë e gjashtëdhjetë të qindat) lekë pa Tvsh.**

**Loti II. “Blerje artikuj bulmetorë” me fond limit: 1,388,465.89 (një milion e treqind tetëdhjetë
e tetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë e tetëdhjetë e nëntë të qindat) lekë pa Tvsh.**

Loti III. “Blerje artikuj ushqimorë dhe fruta perime” me fond limit: 2,850,295.47 (dy milion e tetëqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë e dyzetë e shtatë të qindat) lekë pa Tvsh.

Loti IV. “Blerje mishi dhe nënprodukte të tij” me fond limit: 736,400.21 (shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e katërqind e njëzetë e një të qindat) lekë pa Tvsh.

Burimi i financimit: - 3,223,149.51 (tre milion e dyqind e njëzetë e tre mijë e njëqind e dyzetë e nëntë e pesëdhjetë e një të qindat) lekë pa Tvsh nga Granti

- 2,025,381.66 (dy milion e njëzetë e pesë mijë e treqind e tetëdhjetë e një e gjashtëdhjetë e gjashtë të qindat) lekë pa Tvsh nga Të ardhurat, nga buxheti për Arsimin Parashkollor.

Në bazë të nenit 21, pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor **Bashkia Divjakë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR ÇDO LOT

Loti I. “Blerje buke”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 ”Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2022, 2023 dhe 2024 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në pikën 2/c citohet: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndersa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor, ndersa në pikën 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën. Gjithashtu, vendosja e kriterëve në reference, është bërë që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2/c, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2025.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 8 dhe te nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendët që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë Licencë, kategoria II.1.A.1-“Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 5, germa a, të VKM-se nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Per te provuar pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti i kontraktor kerkon: a) licencat profesionale per prodhimin dhe furnizimin e mallrave, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shtetore.* Vendosja e Licences, kategoria II.1.A.1-“Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, na shërben për shkak se është e lidhur me sigurinë ushqimore. Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në rekomandimin e perbashket te APP dhe AKU, Nr.10181 Prot, datë 19.11.2018, “Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, konkretisht pikes a, te seksionit III,

ku percaktohet se: ...*Ne objektet e prokurimit per prodhim/perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerëz, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë Licencë, kategoria II.1.A.1- “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me certifikatat e mëposhtme:

Çertifikatën e cilësisë **SSH/EN-ISO 9001-2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente;

Çertifikatën e cilësisë **SSH/EN-ISO 22000:2018** (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore) ose ekuivalente, të cilat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijnë objektin e prokurimit.

(Certifikata si më sipër duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Vendosja e SSH/EN-ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Paisja me këtë certifikatë SSH/EN-ISO, garanton që OE konkurues plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

Vendosja e SSH/EN-ISO 22000:2018 na shërben për shkak se është e lidhur me sigurinë ushqimore. Paisja me këtë certifikatë, garanton që OE plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore. Kjo kërkesë i referohet pikes c, te seksionit III, te rekomandimit te perbashket te APP dhe AKU, Nr.10181 Prot, datë 19.11.2018, “Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, ne piken c, te seksionit III, te rekomandimit te perbashket te APP dhe AKU, Nr.10181 Prot, datë 19.11.2018, “Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, si edhe në Ligjin nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se Çertifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që AK të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontratë. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standartit si SSH/EN-ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i SSH/EN-ISO -s rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke*

qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesë vetëdeklarim ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentim: Në bazë të pikes g, te seksionit III, te rekomandimit te perbashket te APP dhe AKU, Nr.10181 Prot, datë 19.11.2018, “Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara ne DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose me qira ose huapërdorje, ambiente të përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuara, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambientet e kërkuara duhet të jenë të pajisur me certifikatë pronësie ose kontratë qiraje, ose kontratë huapërdorje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës,* si edhe në piken d, te seksionit III, te rekomandimit te perbashket te APP dhe AKU, Nr.10181 Prot, datë 19.11.2018, “Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”. Vendosja e këtij kriteri i shërben AK për të siguruar se ofertuesit do ta realizojnë me sukses kontratën sipas kërkesave te percaktuara ne DST.

2.3.6. Për Lotin I. “Blerje buke” operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, ose me qera ose huapërdorje, një automjet të përshtatshëm për transportimin e mallrave.

Për të vërtetuar pronësinë e automjetit dhe për kontrata të qerasë ose huapërdorjes, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë kontratën përkatëse shoqëruar me dokumentacionin përkatës, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik, certifikatën e pronësisë së mjetit, certifikatën e transportit të mallrave, policën e sigurimit të mjetit si edhe foto përkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit.

Kontrata e qerasë ose huapërdorjes duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”*

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken e, te seksionit III, te rekomandimit te perbashket te APP dhe AKU, Nr.10181 Prot, datë 19.11.2018, “Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, si edhe në pikën 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ç të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, ku me anë të cilës të deklarojë se, merr përsipër të kryejë furnizimin dhe shërbimin e transportit të mallit të kërkuar pranë kopështit Divjakë dhe kopështit Çermë Sektor, Njësia Administrative Tërbuf, çdo ditë kopështi, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor, brenda afateve, sasive dhe specifikimeve teknike të përcaktuara.

Argumentim: *Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garanuuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT PËR ÇDO LOT

Loti II. “Blerje artikuj bulmetorë”

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë Autoritetit Kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 8, pika 1 ”Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/ kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe në nenin 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2022, 2023 dhe 2024 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2/c dhe pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter, është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë*

maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa ne piken 2/c citohet: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndersa ne piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor, ndersa ne piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar, argumentohet si më poshtë:

Vendosja e ketij kriteri kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, per te permbushur me sukses kontraten. Gjithashtu, vendosja e kriterëve ne reference, eshte bere që t’i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros, Autoriteti Kontraktor është referuar në pikën 2/c, të Nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i sherben Autoritetit Kontraktor, per te vertetuar se operatori ekonomik pjesëmarrës, i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare, per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2025.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 sipas të dhënave të QKB-së.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të

njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” dhe “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.”

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 40, pika 8 dhe te nenit 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne Ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar. Meqënëse, operatorët ekonomikë kanë detyrimin të paguajnë të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në vendët që ushtrojnë aktivitetin e tyre, atëherë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duhet të vërtetojnë, se i kanë likuiduar këto detyrime nëpërmjet paraqitjes së vërtetimit të lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore përkatëse.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet për secilin prej loteve/shumatores së loteve për të cilat konkuron.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- c. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- d. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme, është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, si edhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë ne vlerën jo më pak se 20% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme, argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës, të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme, të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar, është vendosur që t'i shërbejë Autoritetit Kontraktor, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur, duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme, është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme, zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses, sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë Licencë, kategoria II.1.A.1-“Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 5, germa a, të VKM-se nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Per te provuar pershtatshmerine per te kryer veprimtarine profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti\enti kontraktor kerkon: a)licencat profesionale per prodhimin dhe furnizimin e mallrave, objekt i kontrates, te leshuara nga autoritetet kompetente shtetore.* Vendosja e Licences, kategoria II.1.A.1-“Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, na shërben për shkak se është e lidhur me sigurinë ushqimore. Kjo kërkesë është përcaktuar bazuar në rekomandimin e perbashket te APP dhe AKU, Nr.10181 Prot, datë 19.11.2018, “Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, konkretisht pikes a, te seksionit III, ku percaktohet se: *...Ne objektet e prokurimit per prodhim/perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez, operatori ekonomik ofertues, duhet të disponojë Licencë, kategoria II.1.A.1- “Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.*

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të jetë i pajisur me certifikatat e mëposhtme:

Certifikatën e cilësisë **SSH/EN-ISO 9001:2015** (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente;

Certifikatën e cilësisë **SSH/EN-ISO 22000:2018** (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore) ose ekuivalente, të cilat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit dhe të përfshijnë objektin e prokurimit.

(Certifikata si më sipër duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Vendosja e SSH/EN-ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Paisja me këtë certifikatë SSH/EN-ISO, garanton që OE konkurues plotëson kriteret në funksion të cilësisë së produkteve ushqimore që tregëton, garanton pajtueshmërinë ligjore dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

Vendosja e SSH/EN-ISO 22000:2018 na shërben për shkak se është e lidhur me sigurinë ushqimore. Paisja me këtë certifikatë, garanton që OE plotëson kërkesat për një sistem të administrimit të sigurisë ushqimore. Kjo kërkesë i referohet pikes c, te seksionit III, te rekomandimit te perbashket te APP dhe

AKU, Nr.10181 Prot, datë 19.11.2018, “Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit, në pikën c, të seksionit III, të rekomandimit të perbashkët të APP dhe AKU, Nr.10181 Prot, datë 19.11.2018, “Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, si edhe në Ligjin nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se Çertifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që AK të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontratë. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standartit si SSH/EN-ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i SSH/EN-ISO -s rrit kompetitivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.*

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të operojë duke plotësuar standartet në fuqi për sigurinë ushqimore. Për këtë ai duhet të paraqesë vetëdeklarim ku të deklarojë se nga kontrolli i fundit ka rezultuar se subjekti ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Argumentim: Në bazë të pikës g, të seksionit III, të rekomandimit të perbashkët të APP dhe AKU, Nr.10181 Prot, datë 19.11.2018, “Për hartimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me anë të deklaratave, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjerë të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi ose me qira ose huapërdorje, ambiente të përshtatshme për magazinimin e mallrave të kërkuara, për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës. Ambientet e kërkuara duhet të jenë të pajisur me certifikatë pronësie ose kontratë qiraje, ose kontratë huapërdorje.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*, si edhe në pikën d, të seksionit III, të rekomandimit të perbashket të APP dhe AKU, Nr.10181 Prot, datë 19.11.2018, “Për hartimin e kritereve të veçanta të kualifikimit dhe specifikimeve teknike për prokurimin e produkteve ushqimore”. Vendosja e këtij kriteri i shërben AK për të siguruar se ofertuesit do ta realizojnë me sukses kontratën sipas kërkesave të përcaktuara në DST.

2.3.6. Për Lotin II. “Blerje artikuj bulmetorë” operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë në pronësi, ose me qera ose huapërdorje, një automjet të përshtatshëm ATV frigoriferik për transportimin e mallrave.

Për të vërtetuar pronësinë e automjetit dhe për kontrata të qerasë ose huapërdorjes, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë kontratën përkatëse shoqëruar me dokumentacionin përkatës, leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik, certifikatën e pronësisë së mjetit, certifikatën e transportit të mallrave, policën e sigurimit të mjetit si edhe foto përkatëse ku të jetë e dukshme targa e mjetit.

Kontrata e qerasë ose huapërdorjes duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së kontratës.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST.

